URDHËR
Nr.173, datë 14.3.2020

PËR NDALIMIN E TË GJITHA LËVIZJEVE TË MJETEVE TË TRANSPORTIT NË PIKAT KUFITARE TOKËSORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërma "a" të ligjit nr.15/2016," Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, vendimin e Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit për udhëtarët (autobuza, autovetura etj.), në hyrje dhe në dalje në pikat e kalimit kufitar tokësor duke filluar nga ora 23:59 e datës 15.3.2020. Ky kufizim do të qëndrojë në fuqi deri në një urdhër të dytë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.
2. Përjashtim nga rregulli i caktuar në pikën 1 bëjnë mjetet e transportit për mallrat, produkte ushqimore, barna dhe pajisje mjekësore dhe produkte të tjera të nevojshme për shërbimin shëndetësor.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu